ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA KOSOVARE PËR KRAHASIM DHE VERIFIKIM TË PRONËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **329-24-3260-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **Zhvillimin, Implementimin dhe Mirëmbajtjen e Softuerit Aplikacionit në bazë të mandatit të AKKVP**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**PBC SH.P.K.**
NUI	**810845985**
Adresa	**Rr.Idriz Gjilani p.n.**
Vendi	**Prishtina**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**038600200**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Bashkim Selmani**
Adresa elektronike	**bs@pbc.group**
Data e parashtrimit të ankesës	**05.07.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Zhvillimin, Implementimin dhe Mirëmbajtjen e Softuerit Aplikacionit në bazë të mandatit të AKKVP

Njoftimi për Kontratë: 04.04.2024

Afati i fundit për dorëzim te ofertave: 19.04.2024

Vendimi i AK dhe Letrat Standarde: 21.06.2024

Kerkesa per rishqyrtim: 25.06.2024

Vendimi ne kerkese per rishqyrtim: 26.06.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Kërkesën për rishqyrtim e kemi dorëzuar me datën 25.06.2024, ndërsa AK vendimin për refuzim te kërkesës për rishqyrtim e ka nxjerr me date 26.06.2024

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit,

dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Neni 51.3 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 56.3 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 70 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 71.4 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 59.2 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 1.1 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 108/A.9 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 6.1 të Ligjit për Prokurim Publik;
- Neni 26.9 Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik;
- Interpretimi nr. 29 i KRPP-së, dt. 22/06/2023

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues vazhdon veprimet e kundërligjshme me nxjerrjen e Vendimit të datës 26/06/2024, përmes së cilës refuzon Kërkesën tonë për Rishqyrtim të datës 25/06/2024 (duke shtuar faktin që pretendimet tona nuk janë trajtuar fare, ose janë trajtuar në mënyrë gjysmake), përkundër ofrimit të fakteve dhe provave të cilat ishin në kërkesën tonë për rishqyrtim (shih më poshtë):

I. Autoriteti Kontraktues ka shkelur paragrafin 3 të nenit 51 dhe paragrafin 3 të nenit 56 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP), sepse:
Autoriteti Kontraktues ka diskualifikuar ofertën tonë nga procedura e prokurimit në bazë të një kërkese ose kriteri që **NUK** është i cekur në **njoftimin e kontratës** dhe në dosjen e tenderit, me arsyetimin se:

1. "*Si GoE nuk keni plotësuar kërkesën me numër rendor 7, III.2.4) Kapaciteti Teknik dhe Profesional, në lidhje me ISO standardet e kërkuara ISO IEC 9001 2015 – Certifikatë për Sistem të Menaxhimit të Cilësisë, ku sipas nenit 26.6 të RRPP 001/2022, për Grupin e Operatorëve Ekonomik, secili anëtar duhet ta plotësoj këtë kusht në lidhje me dorëzimin e certifikatave të cilësisë"*

Përkundër që:

2. Një kërkesë e tillë **NUK** ka qenë e kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT) në Dosjen e Tenderit me titull Zhvillimin, Implementimin dhe Mirëmbajtjen e Softuerit Aplikacionit në bazë të mandatit të AKKVP dhe numër 329-24-3260-2-1-1 sikurse e precizon qartazi neni 56, paragrafi 3 i Ligjit për Prokurim Publik.

Duke vepuar kështu, Autoriteti Kontraktues ka shkelur rënd dispozitat ligjore, të cilat shprehimisht thonë se: *Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas*

publikimit të njoftimit të kontratës, ***nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."***

Provë: Njoftimi për Kontratë dhe FDT

II. Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 70 të Ligjit për Prokurim Publik sepse:

Ka diskualifikuar ofertën tonë nga procedura e prokurimit publik duke u thirrur në nenin 26.6 të RRPP 001/2022, edhe pse e njëjta i referohet nenit 70 të Ligjit për Prokurim Publik, ku i njëjti nen saktëson qartazi se [...Autoriteti kontraktues po ashtu **pranon të dhënat e tjera të besueshme për masat e barasvlershme të sigurimit të cilësisë nga operatorët ekonomik që nuk kanë qasje ose mundësi për sigurimin e certifikatave të tilla brenda afateve të caktuara.]**

III. Megjithëse anëtari i grupit RENER SH.P.K. **nuk do të bëj menaxhimin e cilësisë**, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Interpretimin nr. 29 të KRPP-së, të datës 22/06/2023, sepse:

Autoriteti Kontraktues ka diskualifikuar ofertën tonë duke u thirrur në nenin 26.6 të RRPP 001/2022, përkundër faktit që Interpretimin nr. 29 dt 22/06/2023, në paragrafin e fundit saktëson decidivisht se [...Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) **duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit** së bashku me tenderin e tyre.]

IV. Autoriteti Kontraktues, duke mos marrë për bazë faktin që lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomik e posedon certifikatën ISO IEC 9001/2015, ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 71 të Ligjit për Prokurim Publik, sepse:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale hyjnë në nenin 69 të LLP-së. Çdo kërkesë e nenit 69 duhet të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individualë të grupit. Paragrafi 4 i nenit 71 qartazi specifikon se: "*Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit*"

Provë materiale: Certifikata e ISO 9001/2015 e liderit të Grupit të Operatorëve Ekonomik.

V. Autoriteti Kontraktues gabimisht diskualifikon ofertën tonë nga procedura e prokurimit me arsyetimin se: "*nuk keni dhënë një përshkrim konkret të zgjidhjes teknike për specifikat e AK të AKKVP, po ashtu nuk janë ofruar, sqaruar dhe ilustruar skemat e komunikimit të moduleve të platformës e cila garanton funksionalitetin e plotë të sistemit, komunikim dhe ndërlidhje nëpërmjet palëve të përfshira në proces, procedurat dhe politikat e arkivimit të rasteve/lëndëve"*.

Autoriteti Kontraktues, përkundër faktit që këtë pretendim e kemi ushtruar edhe në Kërkesën për Rishqyrtim të datës 25/06/2026, i njëjti vepron kundërligjshëm me paragrafin 9 të Nenit 108/A të LPP-së, ashtu që nuk arsyeton, rrjedhimisht nuk trajton dhe shqyrton pretendimin tonë lidhur me pëshkrimin konkret të zgjedhjes teknike, PËRKUNDËR provës së bashkëngjitur (OFERTËN TEKNIKE), e cila në fq. 69-72 sqaron qartazi secilën nga kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktues.

Një veprim i tillë (mos-trajtimi i pretendimeve të OE-së) nga AK, qysh në gjenezën e tij, saktësisht Vendimi i datës 21/06/2024, e në vazhdën e të njëjtës, saktësisht Vendimi i datës 26/06/2024, përbën lajthitje ndaj ne si OE dhe ndaj jush si OSHP, e njëkohësisht ngërthen në vete dyshime të elementeve të veprave penale Keqpërdorimi i Pozitës apo Autoritetit Zyrtar (Neni 414 i Kodit Penal) dhe Keqpërdorimi dhe Mashtrimi në Prokurim Publik (Neni 415).

Provë: Oferta teknike, fq. 69-72

VI. Autoriteti Kontraktues nuk ka siguruar mënyrën më efikase dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, sepse:

Ka rekomanduar për kontratë ofertën që mban një çmim më të lartë prej 51.5% në raport me çmimin e ofertës sonë, përkundër që:

1. Neni 1 i LPP, thotë se: *"Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.* Dhe

2. Paragrafi 4 i Nenit 59 të LPP thotë se: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të pergjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegishëm nëse:* ***(i) permban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (i) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe n? dosjen e***

tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

Nga sa më sipër, shihet kjartë që Autoriteti Kontraktues mashtron sepse kërkesat teknike dhe profesionale të cilat bien nën nenin 69 të LPP, i ka interpretuar si kërkesa të nenit 70, të cilat më pastaj gjatë vlerësimit të ofertave i ka përfshirë si kritere të kualifikimit, PËRKUNDËR FAKTIT SE kërkesat e nenit 26.6 të RRPP nuk kanë qenë të përfshira në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit tek Kriteret e Kualifikimit, siç kërkohet me nenin 56.3 por vjedhurazi i kanë vendosur tek Specifikimet Teknike.
Pra, i sqarojmë OSHP-së se, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, kërkesa për ISO certifikatë është vendosur në FDT, tek neni 9.1 & 9.2, përkatësisht tek Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale. Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale bien në domenin dispozitat ligjore të nenit 69 të LPP-së. Dhe, çdo kërkesë që vendoset tek Kërkesat mbi Mundësitë Teknike dhe/ose Profesionale mjafton të plotësohen vetëm nga njëri anëtar i grupit. Kërkesa që të gjithë anëtarët e grupit të posedojnë certifikatën, mungon si në njoftimin për kontratë, ndërsa në Dosje të Tenderit është jashtë FDT-së.

Për të faktuar të thënat tona në këtë Ankesë dhe në Kërkesën tonë për Rishqyrtim, ne jemi bazuar edhe në praktikën e prokurimit, ku e njëjta situatë (e spjeguar më poshtë) paraqitet si në aktivitetin tonë të prokurimit, me sqarimin si në vijim:

a) Raporti i Ekspertit Shqyrtues z. Gani Nekaj, i datës 29/02/2024, me numër të lëndës 2024/0130, ndër të tjerash, trajton edhe pretendimin ankimor të njërit prej OE e cila ka kundërshtuar ligjshmërinë e faktit se vetëm lideri i konsorciumit ka dorëzuar certifikatën ISO, ndërsa të njëjtat mungojnë për dy anëtarët tjerë. Këtë pretendim ankimor, Eksperti Shqyrtues e ka trajtuar në faqe 5, 6 dhe 7 të Ekspertizës, ku konstaton se:
CITAT
"Autoriteti kontraktues gjatë përgatitjes se dosjes se tenderit tek kjo kërkesë ju ka referuar numrit
njëjes "Operatori Ekonomi duhet te jetë i certifikuar" dhe si rrjedhoj e kësaj ka krijuar paqartësi tek operatoret ekonomik ne zbatim te nenit 69 , 70 dhe 71 te LPP-së dhe nenit 26.6 te Rr. 01/2022. Kërkesa e autoriteti kontraktues është vendosur tek kapaciteti teknik dhe profesionale qe bie brenda fushëveprimit te nenit 69 te LPP-së dhe si rrjedhoj e kësaj nëse marrim per bazë paragrafin 4 te nenit 71 te LPP-se cili thotë: Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit

Te gjitha paqartesit qe janë ne dosje te tenderit ne lidhje me mënyrën e ofertimit apo sqarimeve te nevojshme qe dalin ne fazën e tenderimit është dashur te sqarohen sipas afateve ligjore te përcaktuara ne dosje te nderit sipas pikës 16.1 Sqarimi i Dosjes së Tenderit

Një sqarim i tillë ne bazë te shkresave te lëndes nuk ka ndodhur dhe si rezultat i kësaj edhe nga te gjithë operatoret ekonomik është kuptuar njejtë kërkesa e autoritetit kontraktues ne lidhje me ISO standardet sepse te gjithë grupet e operatoreve ekonomik kanë dorëzuar çertifikatta ISO ne bazë te nenit 71 paragrafi 4. Edhe vet operatori ekonomik ankues ka vepruar njejtë duke dorëzuar certifikatat ISO vetëm nga anëtari i konzorciumit ndërsa kërkon aprovimin e ankesës
nga Organi Shqyrtues i Prokurimit te aprovoj ankesën si te bazuar dhe lënden te kthejë ne rivlerësim qe bie ne kundërshtim me vet pretendimin ankimor nr 1

Secila dosje e tenderit është në përgjegjësin e autoriteteve kontraktuese te përgatitet ne harmoni te plotë me dispozitat ligjore te Ligjit për Prokurim Publik duke zbatuar parimet e përgjithshme te prokurimit publik. Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre

Po ashtu ne bazë te interpretimit te KRPP-se te dt. 29. 22.06.2023 ne fund te këtij inetpretimi KRPP thekson, citoj "Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre".
Ne dosje te tenderit AK-Spitali i Gjilanit nuk ka përcaktuar kërkesa qe duhet plotësuar ndaras nga anëtaret e grupit sipas përshkrimit te mësipërm

Bazuar ne përshkrimin e mësipërm , shkresave te lëndes, kërkesës se dosjes se tenderit, paragrafi 4 i nenit 71 te LPP-së, nenit 6 te LPP-së eksperti shqyrtues rekomandon qe ky pretendim ankimor është i pa bazuar"
MBARIM CITATI

Pra, siç shihet më sipër, situata e këtij aktiviteti të prokurimit është e njëjtë me situatën tonë, e rrjedhimisht në mënyrë indirekte provon dhe fakton të gjitha pretendimet tona.

Provë: Ekspertiza e datës 29/02/2024, me numër të lëndës 2024/0130, faqe 5, 6, dhe 7

b) Të njëjtën situatë e trajton edhe OSHP në vendimin e saj me numër 2023/0642, me të cilën kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e një OE. Njëri ndër pretendimet e OE ishte se: secili anëtar nuk ka dëshmuar se i plotëson standardet përkatëse (ISO Certifikatat). Me këtë rast, AK do të duhej ta eliminonte nga gara këtë OE, sepse nuk përmbush kriteret për kualifikim (faqe 2 e Vendimit).
Për të vendosur me vendim meritor, OSHP kishte angazhuar eksperten shqyrtuese, e cila përmes raportit 2023/0642, pretendimin e parë të OE ankues e ka sqaruar si në vijim (faqe

7 e Vendimit):
CITAT
"Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "EJONA" SHPK -Pejë, Lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues, se në bazë të nenit 26, pika 26.6, secili anëtar i grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse në lidhje me certifikatat e sigurisë, ku UP Lift si lider i grupit nuk posedon certifikatat për sigurimin e cilësisë. Ekspertja shqyrtues fillimisht sqaron se ***neni 26.6*** *të cilit i referohet OE ankues* ***vlen vetëm*** *në rastet kur autoriteti kontraktues e* ***përcakton*** *në dosje të tenderit* ***në mënyrë të prerë që secili prej anëtarëve të grupit duhet të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse****. Për më tepër, kjo dispozitë që i referohet OE ankues përcakton "Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon certifikata të hartuara nga organe të pavarura...", sipas kësaj dispozite ligjore, AK-së i lejohet që të vendos NËSE kërkon që secili prej anëtarëve duhet të përmbush këto standarde përkatëse, ku në rastin konkret AK nuk e ka kërkuar një gjet të tillë. Për më tepër, ekspertja shqyrtuese sqaron se neni 71, par. 4 i LPP-së përcakton se çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të LPP-së do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit. Në rastin konkret, kërkesa e vendosur në dosje të tenderit "3.Operatori duhet te jete i çertifikuar sipas standardeve ISO 9001 , ISO 14001 dhe ISO 18001" bënë pjesë të mundësitë teknike dhe/ose profesionale, e cila kërkesë buron nga neni 69 i LPP-së. Sa i përket pikës ankimore të OE ankues në lidhje me Rregulloren MTI Nr.05/2018 Për Sigurinë e Ashensorëve në Përdorim, neni 5 (Mirëmbajtësi i ashensorit), ekspertja shqyrtuese sqaron se sipas dosjes së tenderit, kjo rregullore të cilës i referohet OE ankues nuk është kriter vlerësues pasi që në dosje të tenderit askund nuk është cekur/kërkuar kjo rregullore. Nëse kjo rregullore paraqet ndonjë rëndësi për sigurinë e ashensorëve, është përgjegjësi e zyrtarëve kompetent pranë AK-së që gjatë përpilimit të dosjes së tenderit të caktojnë kritere apo kërkesa që nuk cenojnë sigurinë e përdoruesve. Në anën tjetër,* ***duke pasur parasysh nenin 56.3 të LPP-së, është e ndaluar që të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura tenderuesi në bazë të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit."***
MBARIM CITATI

Pra, me të drejtë ekspertja shqyrtuese ka dhënë këtë sqarim, ashtu që ka respektuar plotësisht dispozitat ligjore të LPP-së. **NË TË NJËJTËN MËNYRË** vepron edhe OSHP, e cila duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe RRPP-së, arsyeton vendimin e saj (ndër të tjerash) në faqen 10, paragrafi i parë, si në vijim:

CITAT
"Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertes shqyrtuese dhe mendimi i saj janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes pa nevojë që të njëjtat të përsëriten sërish"
MBARIM CITATI

Provë: Vendimi i OSHP nr. 2023/0642, fq. 2, 7 dhe 10

Jemi të sigurtë se ka më shumë se këto dy raste të praktikës së prokurimit publik në rrafshin juridik të tyre, e që implikojnë drejtpërsëdrejti OSHP-në në vendime meritore për këso situata puro të njëjta si ky aktivitet prokurimi.

Nga sa më sipër, nga të gjitha të thënat, provat dhe faktet, kërkojmë nga OSHP që

1. TË ANULOJ Vendimin e AK të datës 21/06/2024, ku së bashku me anulimin do të anulohet edhe çfarëdo pasoje juridike të prodhuar, apo që do të prodhohet në të ardhmen, dhe
2. Lënda të kthehet në RIVLERËSIM.
3. Gjatë rivlerësimit, të aplikohet LIGJSHMËRIA ashtu siç e kërkojnë dispozitat ligjore të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale do te përcaktohen pas nje analize financiare

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*